ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **I.K. I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **711-24-6006-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Matja e kënaqshmërisë së pacientit në kujdesin shëndetësor ambullantorik dhe spitalor në Kosovë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**global CT Digital Kosovo SH.P.K.**
NUI	**811405936**
Adresa	**Hyzri Talla, nr. 58, kati 3, nr. 12**
Vendi	**Prishtine**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**038773777**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Albert Aliu**
Adresa elektronike	**digitalkosovo@globalct.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**09.09.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Matja e kënaqshmërisë së pacientit në kujdesin shëndetësor ambullantorik dhe spitalor në Kosovë

Autoriteti Kontraktues ka publikuar projektn me titull: Matja e kënaqshmërisë së pacientit në kujdesin shëndetësor ambullantorik dhe spitalor në Kosovë

Njoftimi per kontrate eshte publikuar me daten: 14.06.2024

Afati i fundit per dorezimin e ofertave: 08.07.2024

B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues: 28.08.2024

Kerkesa per qasje: 28.08.2024

Dokumentet e derguara permes eProkurim nga AK: 30.08.2024

Kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar me daten: 30.08.2024

Pergjigja ne kerkesen per rishqyrtim nga AK: 02.09.20224

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Ofertat jane hapur permes eProkurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kompania jonë si operator ekonomik pjesë e procesit tenderik në fjalë, si palë e

pakënaqur me vlerësimin e bërë nga AK ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Edhe pse janë evidentuar lëshime substanciale në ofertën e operatorit ekonomik që pretendohet ti jepet kontrata, autoriteti kontraktues prapë me anë të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim i cilëson sig abime ose lëshime gjatë procesit që nuk qojnë peshë në vlerësimin e ofertës.

Për ne është e pakuptimtë sesi:

1. Autoriteti Kontraktues shkele LPP-në, rrjedhimisht nenin 7 në këtë form duke diskriminuar kompaninë tonë e duke tentuar të favorizoj me cdo kusht OE-në specifike edhe në mungesë të dokumenteve kruciale që kanë qenë pjesë e vlerësimit të ofertave,

2. Sigurimi i tenderit si kusht elementar i një oferte nuk është sikurse Aneksi 4 i dosjes së tenderit as për nga forma e as për nga përmbajtja, gjë që e bën dokument të pavlefshëm, e që është trajtuar edhe në vendimet e mehërshme të OSHP (vendimi OSHP 2024/0306)

3. Deklarata nën betim nuk është në formatin e dosjes së tenderit, por AK prapë nuk e ka trajtuar bazuar në provat materiale të depozituara.

4. Nuk ka deklaratë për specifikacion teknik e as specifikacion teknik të detajuar, pra AK nuk e din se çfarë do të pranoj si product a shërbim përfundimtar. E përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim është e quditshme dhe konfuze, sepse me përgjigjen e tyre ata thojnë, citojmë: Në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me kontratë për furnizim por me kontratë për shërbime ku AK nuk ka përcaktu kërkesat minimale dhe maksimale.

Kjo nuk qëndron aspak, sepse AK në dosjen e tenderit në aneksin 1 ka përcaktuar kërkesat minimale të projektit, e që rrjedhimisht nuk është e qartë se si do të dorezohet softueri i kërkuar, e kujt është pronësia, a do të dorëzohet për shfrytëzim apo me kod burimor.

Prandaj, AK me përgjigjen e shkresës për rishqyrtim bie ndesh me vetë dosjen e vete!

5. Janë kërkuar decidivisht diplomat e noterizuara, ndërsa edhe pse është njoftuar AK që kjo përbën shkelje, të njëjtit e kanë arsyetuar veprimin që kinse janë të skanuara nga origjinali, do të thotë kërkesa në dosje për diploma të noterizuara ka qenë e kotë. Prandaj, AK nëse vendos si kriter diplomat e noterizura, mendojmë se duhet ti vlerësoj të njejtjat nëse janë dorëzuar e jo të aludoj se janë skanuar nga origjinali (kush e ka informuar AK që nuk janë skanuar nga kopja por nga origjinali).

6. E më e quditshmja është që mungojnë nenshkrimet e palëve përkatëse në parakontratë për angazhim për këtë projekt, pra, dihet botërisht edhe është e përcaktuar në LPP e në ligjin për marrëdhënie detyrimore se nëse një dokument nuk është i nënshkruar nga dy palët, i njejti ka vlerën null. Por për AK-në as kjo pjesë nuk është cilësuar si shkelje, e edhe në kërkesën për rishqyrtim është munduar të arsyetoj këtë shkelje duke thënë, citojmë:

… stafi i deklaruar ka marrë pëlqimin për angazhim në këtë projekt gjë e cila dëshmohet me nënshkrimin e tyre si ofrues i shërbimeve por duke mos paragjyku fituesin nuk ka hy në obligime duke nënshkrim si pranues i shërbimeve.

Por, në dosje shkruan: kontrata e punës ose marrëveshja e bashkëpunimit, e nëse një dokument nuk është i nënshkruar nga dy palët ofruesi i shërbimeve dhe pranuesi i

shërbimeve, i njejti dokument para çdo organi ka vlerën null. E që rrjedhimisht, të gjitha parakontratat ose kontatat e punës mungon nënshkrimi i pranuesit të shërbimeve.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që të vlerësoj provat materiale që janë pjesë e ofertës së OE-së fituese dhe te kthej lëndën në rivlerësim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjinNr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Neni 59 i LPP - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L092 dhe rregullores ne fuqi per prokurim publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 7 te Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sepse:

Autoriteti Kontraktues nuk na ka trajtuar në mënyrë të barabartë operatoret ekonomik pasi qe oferten e papergjegjshme te operatorit ekonomik e ka konsideruar si te pergjegjshme. Pasi qe e njejta ka mangesi ne:

1. Deklarata nën betim është ndryshuar/fshier/modifikuar koka e deklaratws nwn betim (titulli dhe numri i prokurimit) dhe poashtu pjesa e poshtme (footeri)
2. Mungon Deklarata për permbushjen e specifikacionit teknik,
3. Sigurimi i tenderit nuk eshte konform LPP dhe RRUOPP,
4. Diplomat e stafit jane kerkuar te noterizuara ndersa asnje diplome nuk eshte e

noterizuar
Prandaj, te gjitha keto qe u thane me siper tregojne se AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se.

2. Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar ne plotni nenin 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, rrjedhimisht paragrafin 5 sepse:
1. Nuk ka siguruar nje kopje te te gjitha materialeve per te cilat ne si pale e interesuar kemi kerkuar.
Qasja na eshte mundesuar vetem duke u derguar dokumentet permes e-Prokurimit, por te njejtat nuk jane derguar te plota, pra mungojne dokumente e
deshmi te cilat besojme se jane dorezuar tek AK nga OE-te perkatese.

Tek oferta fituese mungojne dokumentet PDF qe kane numerizimin 2, 8 dhe jane derguar vetem 1,4,5,6,7,9.

Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe rregullores ne fuqi per prokurim publik pasi:
- Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, e qe ne rastin konkret gjate analizimit te dokumentacionit te pranuar nga AK permes e-Prokurimit me rastin e kerkimit te qasjes kemi verejtur qe:
1. Deklarate nen betim eshte ndryshuar/fshier koka e deklarates nen betim (titull dhe numri i prokurimit) dhe poashtu pjesa e poshtme (footeri)

E ku AK ne dosje e ka cekur:
Evidenca 1 Një deklarata e shkruar nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2 - obligative E nese analizohet deklarata nen betime OE-se fituese, mund te shihet qarte se mungojne pjese te domosdoshme te cilat jane ne Aneksin 2 por jo edhe ne deklaraten e OE-se fituese.
E edhe sipas RRUOPP-se e shume ankesave te meparshme ne OSHP-se, nje nderhyrje e tille (fshierje e pjeseve) e ben jo-valide deklaraten nen betim. Ne nje vendim te OSHP me numer 1152/20 eshte potencuar qe ne rast se Deklarate Nen Betim nuk eshte plotesuar sipas kerkeses atehere tenderi duhet te refuzohet.
Prove Materiale1: Aneksi 2 – deklarata nen betim nga dosja
Prove Materiale 2: Deklarata nen betim e OE-se
Prove Materiale 3: Vendimi i OSHP 1152/20 i dates 26.01.2021

2. Sigurimi i tenderit nuk eshte konform LPP-se dhe Aneksit 4
Gjate analizimit te dokumentacionit kemi verejtur se Sigurimi i Tenderit si kriter administrativ i dosjes se tenderit nuk plotesohet nga Operator Ekonomik ne fjale.
Kjo pasi qe nuk eshte perdorur shablloni ne Aneksin 4 Siguria e Tenderit as per nga forma (forme komplet e ndryshme) e as per nga permbajtja (tekstualisht nuk
eshte dokument i njejte me aneksin 4). Pra, eshte perdorur forme tjeter qe nuk forma standarde dhe per me teper tekstualisht eshte e ndryshme nga shablloni i
sigurimit te tenderit.

Gje e njejte munde te verehet edhe tek operatori ekonomik NSH CMD ku nuk eshte perdorur shablloni ne Aneksin 4 – Siguria e Tenderit as per nga forma (forme komplet e ndryshme) e as per nga permbajtja (tekstualisht nuk eshte dokument i njejte me aneksin 4), gje qe e ben jo valid kete sigurim dhe poashtu oferten e NSH CMD te papergjegjshme.

Per informaten tuaj Autoritete te ndryshme kontraktuese dhe vendime te OSHP-se e kane trajtuar kete qeshtje dhe citojme lenden me nr. OSHP 2024/0306 ku
eksperti shqyrtues ne faqen 7 ne nje situate te ngjashme ka thene:
Në lidhje me këtë rrethanë, sipas udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik (UPP), përkatësisht nenit 10, paragrafi 1, në rastet kur Sigurimi i
Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT, refuzohet tenderi pa kërkuar informacion të
mëtejshëm.

Prove materiale 4: Raporti i ekspertit shqyrtues te lendes: OSHP 2024/0306

3. Mungon Deklarata per specifikacion teknik per sherbimet e ofruara dhe poashtu asnje dokument tjeter nuk eshte bashkangjitur
Gjate analizimit te dokumentacionit te pranuar na Autoriteti Kontraktues permes e-Prokurimit kemi verejtur qe ne asnje nga fajllat nuk ezksiton dokument me titull:
Deklarata per specifikacion teknik apo specifikacion teknik i detajuar ne lidhje me kerkesen e AK-se dhe oferten e OE-se. E per rrjedhoje nuk dihet se cfare do te
pranoni ju si AK nese nenshkruhet kontrata me OE-ne ne fjale sepse nuk ekziston asnje deshmi ne lidhje me softuerin qe do te pranoni.
Prandaj, konform nenit 10.1 te udhezuesit nr. 001/2023 faqe 41 thuhet:
Problemi: Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një
produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara.

Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të
jene ne përputhje

Si të veprohet?
Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm
Neni i LPP-se: 28

Por, Autoriteti kontrakues ka vepruar ne kundershtip me LPP-ne dhe udhezuesin ne fjale duke mos vepruar konform nenit 10.1 te udhezuesit nr. 001/2023.

Mungojne diplomat e noterizuara te stafit te angazhuar Autoriteti Kontraktues ne dosjen e tenderit ka kerkuar:

1. OE duhet të dëshmoj se ka stafin adekuat përgjegjës për ofrimin e shërbimeve a. së paku dy inxhinier të shkencave kompjuterike të diplomuar me shkallën
Bachelor. b. OE duhet të emëroj një udhëheqës të projektit me kualifikim të paktën me shkallën Bachelor

shkencat kompjuterike Evidenca 1 Listën e personelit teknik pavarsisht nëse i takojnë apo jo drejtpërdrejt operatorit ekonomik, përgjegjës për implementimin e projetit. Listës duhet bashkangjitur a. Kopja e noterizuar ediplomës, kontrata e punës ose marrëveshja e bashkëpunimit.

Gjate analizimit te dokumentacionit te OE-se kemi verejtur se asnje nga diplomat e dorezuara te stafit nuk eshte e noterizuar. Ne rast te ngjashme ne ankesa e vendime te OSHP-se mund te shihet qarte se ne rate te tilla duhet refuzuar tenderit pa kerkuar sqarime shtese sepse nuk eshte plotesuar kerkesa per kopjen e noterizuar te diplomes sic ka qene e percaktuar ne dosjen e tenderit.

Poashtu, ne te gjitha kontratat e punes mungon nenshkrimi i perfaquesit te kompanise ne fjale, gje qe e ben te pa vlefshme si kontrate, e ne shperputhje me LPP-ne dhe rregullativen e udhezuesit ne fuqi dhe poashtu me kerkesen tuaj, pra nuk permbushen kerkesa per: kontrata e punës ose marrëveshja e bashkëpunimit ne mungese te nenshkrimit te perfaquesit te OE-se gje qe e ben kontraten te pa vlefshme.

Prove materiale 6: Raporti i Ekspertit Shqyrtues 2024/0613
Proe materiale 7: Vendimi i OSHP-se 2023/0877

Duke pasur parasysh te gjitha shkeljet qe kane ndodhur gjate vlerësimit,Kërkojmë qe kjo ankese te aprovohet dhe lenda te kthehet ne rivleresim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Me ane te ketij vendimi AK cenon te shkaktoj deme te pariparueshme, sepse oferta te papergjegjshme cilesohen si te pergjegjshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*